



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Nr. Extra prot.

Tiranë më 20. 09.2022

Lënda: Dërgohet raporti i monitorimit të buxhetit për 8 mujorin 2022 me anekset përkatëse

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
Tiranë

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), si Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri, është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e gjithë veprimtarisë kombëtare të standardizimit, me qëllim plotësimin e nevojave të palëve të interesuara për standarde teknike për të gjitha fushat e ekonomisë.

Misioni i punës së veprimtarisë së standardizimit është të sigurojë plotësimin e nevojave të të gjitha palëve të interesuara (industria/biznesi, tregtia, autoritetet publike, ambientalistët, konsumatorët, SME-të, academia) për standarde teknike bashkëkohore në të gjitha fushat e ekonomisë, në mbështetje të konkurrueshmësisë dhe reduktimit të Barrierave Teknike në Tregti.

Qëllimi është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, kafshëve si dhe mjedisit.

Këto janë materializuar edhe ndërmjet qëllimit të programit 04160, i cili është: Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale

Për përmbushjen e sa më sipër, objektivat e DPS janë:

- Të përafrojnë legjislacionin kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC).
- Të zbatojë dhe rishikojë të gjithë paketën ligjore për proceset e integritetit në fushën e standardizimit.
- Të organizojë dhe drejtojë punën për progresin në adaptimin e standardeve evropiane dhe informimin e ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë dhe palëve të interesuara për rëndësinë e standardeve
- Të mirëadministrojë Sistemin e Menaxhimit të Standardeve (SMS), shitjen e tyre dhe mirëfunksionimin e Autoritetit Kombëtar të Notifikimit dhe Pikës së Referimit në OBTA dhe CEFTA.
- Të funksionojnë sa më mirë strukturat e DPS (Bordi Drejtues, Bordi Teknik dhe Komitete Teknike)

Nëpërmjet këtij relacioni, si dhe formateve bashkëlidhur, informojmë mbi objektivat, treguesit e performancës në nivel qëllimi, objektivi si dhe produktet e realizuara, në sasi e vlerë, për 8 mujorin 2022.

Produktet sipas Programit : Mbështetje për mbikqyrjen e tregut,infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale me kod 04160, janë Standarde evropiane dhe ndërkombetare të adaptuara, miratuara si SSH si dhe Shitja e Standardeve.

1. Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH)

Në kuadër të aplikimit të Sistemit të Ri të Menaxhimit të Standardeve, si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 382 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit” e cila është amenduar në muajin Nëntor të vitit 2021, DeS ka përgatitur programin e punës një vjeçar, sipas të cilit adoptimi i standardeve dhe i dokumenteve të standardizimit është shtrirë në periudhën **Maj-Dhjetor 2022**.

Parashikimi për 8 mujorin e v. 2022 ishte të adaptohen si SSH gjithsej **1,018** standarde sipas programit të punës së Drejtorisë së Standardeve. Në fakt janë adaptuar **1,093** standarde, me një realizim 107 %, të detajuara si në tabelën 1

Tabela 1 Adaptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si SSH për 8 mujorin 2022

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	Fakt	Realizimi në %
1	Standarde të adaptuara (CEN/CENELEC)	568	614	108 %
2	Standarde të ETSI	200	200	100 %
3	Standarde të ISO/IEC	250	279	112 %
	Totali	1,018	1,093	107 %

Gjithashtu, gjatë këtij 8 mujori, janë regjistruar në Sistemin e Menaxhimit të Standardeve (SMS) të gjitha projektstandartet dhe projektdokumentet e standardizimit të cilat janë për adoptim gjatë kësaj periudhe (faza 40.20), e cila është faza që një projektstandard dhe një projektdokument kalon për mendim publik, dhe publikohet në Katalogun e Standardeve Shqiptare online për të pritur komente nga palë të interesuara, ose grupe të caktuara interesi. Kjo fazë ka përfunduar në datë 11 Maj 2022 (mbyllja e mendimit publik) dhe të gjitha standartet dhe dokumentet e standardizimit kanë kaluar në Komitetet Teknike për të filluar adoptimin e tyre sipas programit të punës së Drejtorisë së Standardeve sipas fushave dhe muajve të caktuar. Në këto kushte, adoptimi i standardeve sipas planit të punës shtrihet në periudhë 4 mujore: Maj-Gusht 2022, gjithashtu për periudhën 8 mujore (Janar-Gusht 2022) janë adoptuar dhe standarde dhe dokumente standardizimi me procedurë të përsheptuar me kërkesë nga palë dhe grupe të interesuara.

2. Përafrimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC). Objektivi është të zbatohet dhe rishikohet të gjithë paketën ligjore për proceset e integritimit në fushën e standardizimit. Në këtë kuadër punohet për evidentimin e të reja sipas situatës në fushën e standardizimit.

3. Promovimi dhe publikimet

Janë përgatitur gjithsej **21** Artikuj me titujt:

1. Rritja e pjesëmarrjes së femrave në kërkimin shkencor
2. Ekonomia e ndarjes dhe tregtia elektronike ofrojnë stabilitet ndërkombëtar
3. Ndryshimet shoqërore që formësojnë të ardhmen tonë

4. Mbajtja e premtimit për një mjedis të gjelbër
5. Avancimi i barazisë gjinore krijon një botë të qëndrueshme
6. Rrjetet sociale dhe menaxhimi i situatave të vështira
7. Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN) dhe Komiteti Evropian për Standardizimin në fushën e elektroteknikës (CENELEC) njoftojnë mbajtjen e konferencës për standardizimin e legjislativitetit të sigurisë kibernetike në Bashkimin Evropian
8. Ndërtimi i një të ardhmeje më të shëndetshme për të nesërmen
9. Të hash si vendasit
10. Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN), sapo ka publikuar specifikimet e reja teknike për produktet plehëruese duke u bazuar në objektivat e ekonomisë rrethore të Be
11. Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN) dhe Komiteti Evropian i Elektroteknikës për Standardizimin (CENELEC) kanë krijuar një hartë të re për standartet evropiane, të cilat mbështesin Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDGs)
12. Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO) sapo ka publikuar një udhëzues të ri për testimin e COVID-19
13. Konsumatorët e pambrojtur
14. E ardhmja e kujdesit shëndetësor
15. Ushqim i sigurt, shëndet i mirë dhe një e ardhme e shkëlqyer
16. Ti mbajmë të sigurtë zjarrfikësit
17. Ekonomia e re bazohet në projekte
18. Tendencat në zhvillimin e llojeve të turizmit
19. Dita Ndërkombëtare e Standardeve për vitin 2022
20. Të ruajmë ekosistemet natyrore
21. Organizimi i trajnimit të thelluar të stafit të DPS në lidhje me kërkesat e standardit SSH EN ISO 9001:2015

Publikuar 58 ekstrakte standardesh të fushave:

Pajisje elektroshtëpiake; Pajisje inxhinierike; Materiale ndërtimi; Produkte ushqimore; Kimia; Sporti; Mjekësia; Siguria ushqimore; Siguria e lodrave; Artikuj për fëmijë; Pajisje mbrojtëse personale; Lëndë djegëse; Artikuj për fëmijë; Pajisje për pishina; Sisteme alarmi; Trafiku rrugor; Turizmi; Materiale për paketim; Lëndë drusore; Makineri përpunimi; Ndriçimi; Makina dhe traktorë në bujqësi

Janë publikuar 3 Buletine, përkatësisht:

Buletini Nr.89, Buletini Nr.90 dhe Buletini Nr. 91.

Janë organizuar dy mbledhje, një mbledhje e bordit teknik dhe një mbledhje e bordit drejtues.

Janë organizuar 2 aktivitete promovuese mbi rolin dhe rëndësinë e standardeve në infrastrukturën e cilësisë, në qytetin e Gjirokastrës dhe në qytetin e Korçës, në kuadër të kalendarit të aktiviteteve promovuese të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu, janë shitur gjithsej 364 standarde, nga këto 317 janë Evropiane (EN). Standardet me të shitura janë të fushave:

- Produkte nafte, lubrifikantë, qymyre dhe produkte që lidhen me to

- Agregate dhe muraturë
- Analizat e produkteve ushqimore. Materialet në kontakt me ushqimin

Realizimi i Treguesve ekonomiko-financiare (Aneksi 2)

Buxheti vjetor i akorduar për DPS, konsiston në mbështetjen logjistike të ushtrimit të kompetencave e funksioneve të institucionit, për arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjatë vitit kemi pasur disa rialokime të fondeve buxhetore dhe buxheti vjetor i rishikuar i institucionit rezulton i alokuar për paga 50%, sigurime 9 %, shpenzime operative 6%, pagesë të kuotave ndërkombëtare 28%, dhe investime kapitale 7 % (Tabela 2).

Table 2 Plani buxhetor 2022 dhe % e zërave të shpenzimeve kundrejt totalit

Në mijë lekë			
Nr.	EMËRTIMI	PLANI BUXHETOR 2022	NË % NDAJ TOTALIT
1	Paga	15.000	46 %
2	Sigurime shoqërore	3.000	9 %
3	Mallra e shërbime të tjera	4.960	15 %
4	Transferta Korente të Huaja	8.040	27 %
5	Transferta tek individët dhe familjet	128	0 %
6	Investime	1.000	3 %
	Totali	32,128	100%

Nga fondi i planifikuar prej **24,812 mijë lekë** për 8 mujorin 2022, DPS ka shpenzuar **vlerën 19,944 mijë lekë**. Buxheti është realizuar në masën **80 %**, (tabela 3)

- **Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore (600-601)**, është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën **10,073 mijë lekë** për paga ose pothuaj **89 %** e fondit të planifikuar të shpenzimeve prej **12,000 mijë lekë** Stafi i DPS është i plotë me 14 nëpunës civilë, 1 punonjës administrativ dhe 1 punonjës me kontratë.

Në tabelën e mëposhtme, pasqyrohet realizimi në % dhe vlerë, i secilës kategori shpenzimesh, përkundrejt buxhetit të akorduar.

- **Fondi për Shpenzime Korrente të tjera (602-606)**, për 8 mujorin 2022 është realizuar në vlerën **9,200 mijë lekë**, nga **11,812 mijë lekë të planifikuara** ose rreth **78 %** e fondit të planifikuar tek 602. Ky fond është përdorur për:
 - Shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, si detyrime energji elektrike, ujë, shërbime bankare, postare e telefonike.
 - Shpenzime për transferta korrente të huaja, të cilat janë pagesa të kuotizacioneve të organizmave evropiane e ndërkombëtare, në të cilat DPS bën pjesë
 - Shpenzime korrente te tjera

Table 3 tabela e akordimit të fondeve buxhetore 8 mujori, 2022 dhe realizimi në vlerë dhe %

Në 000 / lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	FAKT	REALIZIMI NE %
1	Paga	10,000	9,173	92 %
2	Sigurime shoqërore	2,000	1,530	76 %
3	Mallra e shërbime të tjera	3,687	1,136	31 %
4	Transferta Korente të Huaja	8,040	8,040	100 %
5	Trans per Buxh. Fam. & Individ	85	24	28 %
6	Investime	1,000	40	0.4 %
	Totali	24,812	19,943	80 %

- **Fondi për shpenzime investime (zëri 230, 231)**, ku vlera e planit vjetor të fondit të investimeve ishte 1,000,000 lekë.

Në zbatim të planit për shpenzime dhe investime, DPS ka hartuar planin e prokurimeve, i cili për vitin 2022, 1 procedurë prokurimi (shpenzime kapitale), me objekt **“Blerje pajisje TIK” (hardware), të cilat prokurohen nga AKSHI** prokurime në vlerën **1,000,000** lekë. Nuk është realizuar për shkak se DPS e kishte rinovuar fondin e kompjuterave dhe nuk do të bënim prokurimin për këtë vit. Por pas sulmit kibernetik, disa kompjutera kanë dalë jashtë përdorimi dhe duhen azhurnuar me nivelet e përcaktuara nga AKSHI. Koha është e kufizuar për prokurimin e PC të rinj, pasi duhet miratimi i AKSHI-për të nisur procedurat.

Në **Aneksin nr. 3** është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) në zbatim të objektivave për 8 mujorin 2022.

- Produkti 1 Adoptimi i Standarteve CEN/CENELEC
- Produkti 2 Adoptimi i Standarteve ETSI
- Produkti 3 Adoptimi i Standarteve IEC/ISO
- Produkti 4 Standarte te shitura

➤ **Të ardhurat nga Shitja e standardeve**

Për 8 mujorin e vitit 2022 janë shitur gjithsej **364** standarde, dhe të ardhurat e realizuara në vlerë janë **730,735** lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

RIZA HASANAJ

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit				Kodi i Grupit		4160	
Programet		Shpenzimet e MFE/DPS							
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti 8 mujori	Fakti 8 mujor	Diferenca	
Titulli	Emertimi	i vitit paraardhes Viti 2021	Viti 2021	Plan Fillestar Viti 2022	Plan i Rishikuar Viti 2022	Plani i Periudhes/progresiv	i Periudhes/progresiv		
0001	Programi 1	27,954	32,500	36,348	32,128	24,812	19,943	-4,869	
0002	Programi 2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
0003	Programi 3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
0004	Programi 4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		27,954	32,500	36,348	32,128	24,812	19,943	-4,869	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit		0	0	0	0	0	0	0	
Totali		27,954	32,500	36,348	32,128	24,812	19,943	-4,869	

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit	Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit		Kodi i Grupit	10
Programi	Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale		Kodi i Programit	04160
Art.	Emertimi	(5) Buxheti 8 mujor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti 4 mujor i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	10,000	9,173	-827
601	Sigurime Shoqërore	2,000	1,530	-470
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,687	1,136	-2,551
603	Subvencione	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	8,040	8,040	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	85	24	-61
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	23,812	19,903	-3,909
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	1,000	40	-960
232	Transferta Kapitale	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	1,000	40	-960
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	40	40
232	Transferta Kapitale	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	1,000.0	40.0	-960.0
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti		0.0	0.0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		24,812	19,943	-4,869

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	MFE/Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit	Kodi i Grupit	10
Programi	Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale	Kodi i Programit	04160

ne 000/leke					I			II			III			IV
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhes) 2021	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes) 2021	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes) 2021	Sasia (sipas planit 8 mujorit) 2022	Shpenzimet (sipas planit) 2022	Kosto per Njesi (sipas planit) 2022	Sasia (sipas planit te rishikuar)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar)	Sasia Faktike (ne fund te 8 mujorit)	Shpenzimet Faktike (ne fund te mujorit)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te 8 mujorit)
A	Adoptimi i Standarteve & Shitja e tyre	Numer	3,428	27,160	8	1,696	28,232	17	1,696	24,812	15	1,457	19,943	14
B														
C														
D														
	TOTALI		3,428	27,160	8	1,696	28,232	17	1,696	24,812	15	1,457	19,943	

